

# **S H E F K I O S E K U**

**Një lloj drite tjetër**

Përmbledhje me poezi

**Lektorë – korrektorë:**

**Shqiptar Oseku, Suedi**

**dhe**

**Hazyr Dervishi, Kosovë**

---

**Përpunimi kompjuterik:  
Frashër Oseku**

---

**U shtyp me ndihmën e ABF-it  
në Treleborg - Suedi**

---

**Për herë të parë u botuar më 1997**

**Ribotuar më 2004**

**Tirazhi 1.000 kopje**

Me mirënjohje ish presidentit të SHBA-ve, z. Bill Clinton,  
kryeministrit të Britanisë së Madhe, z. Toni Bler si dhe vendeve  
anëtare të NATO-s, për ndihmën e dhënë.

POETI

NËNËS

**N Ë N Ë S**

**shumësin ta kanë krijuar  
gramatikanët marroqë**

## KRUSHQIT

hipur mbi kuaj, mbi qerre me qilima mbuluar  
nisen për ta marrë nusen, fillin e jetës  
e larg, shumë larg, jehon kënga e tyre  
- j-o-o-o, p-o-o-o!  
- j-o-o-o, p-o-o-o!

thua qindra herë e kanë lexuar Hamletin  
fshatarët e mi analfabetë

- j-o-o-o, p-o-o-o!  
- j-o-o-o, p-o-o-o!

## NUSJA

ditë e re, e  
ajo askund s'po duket  
nusërimi mbrëmë dhe e mërkura  
kurrresi s'po e lëshojnë të kthehet  
prej shtegut, prej lisit, prej kroit...  
e krushqit po presin!  
mos motër, gjë e ligë mos e gjettë shtëpinë e babës!  
lotët e tu mbi kufomën e vashërisë pikojnë  
që sonte po varroset diku larg  
pas shtatë bjeshkësh  
në gjerdekun e panjohur

## DHËNDRI

po vijnë krushqit rrëzës së malit...

dy fshatarë iu ngjitkan një shpati  
vallë, pse nxitojnë kaq shumë?  
kërkokan drunj gështenje dhe  
pa bëza rrëmokan, një varr  
as të cekët, as të thellë  
jo nënëlokes, e cila mordjes së vet moti i ka dredhuar,  
veç djalit të dëshirit  
që po ia mbyll të Nesërmen me therrë  
po, ajo gjallë se gjallë  
- ç-o-o-u R-e-x-h-o-o , ç-o-o-u d-j-a-l-o-o !  
- j-o-o-o, p-o-o-o !

## SHQIPËRIA

Shqipëria ka male e fusha  
lumenj e dete...  
por, ajo ka diç  
që pak kush e di  
i ka edhe shtatëmilionë zemra  
të ruajtura në fishekzaret e mordjes  
për të pabesin  
për të pashpirtin  
armik



## KOSOVËS

në bri të dhisë të kanë ngujuar  
e po t'i rrënojnë kullat e tua në zë  
të bukekripës në sofër të mikut  
dyerhapurat natë e ditë

oh! si po çirren të dehur  
mbi kokën tënde shamizezë  
e po pështyjnë horras  
mbi fytyrën tënde nusërore  
bajlozi i zi po trand male e fusha  
me thundrat e hekurta  
mbi trupin tënd, Kosovë!

hiç dhembje s'po kanë  
këto jokrijesa të këtij Parashekulli  
gjallimit tënd po ia numërojnë  
orët  
minutat  
sekondat

po ti s'vdes dot  
thonë, engjëlli nuk jep shpirt  
ai deri në amshim duron  
deri në rilindje të Gjergj Elez Alisë  
me shtatëqind plagë të marra në trup  
ndër mote

## S'PASKA ZOT, AS PERËNDI

nuk paska shenjtëri  
as profet madje, as Zot as Perëndi!  
koka po u dhemb shkronjave  
nga emrat Krisht, Muhamet, Marks,  
nga fjalët hyjni, barazi, të drejta njerëzore...

mbi abetaren time të lidhur në pranga  
hije po bën drapëçekani i Lenin - Stalinit  
përmendorja e Lirisë së Vashingtonit  
dega e ullirit në sqep të pëllumbit të OKB-së  
fjala paqe e shkruar me germa të mëdha  
mbi qefinin e bardhë të fisit tim  
fatzi

im bir hipur mbi kullën e Dukagjinit  
zëshëm po çirret, o Zot, ku je?  
po bythecët me kundërmim pomade  
në pallatet e akulllandit  
të OSBE - së, OKB - së, BE - në  
në Gjenevë, Nju York, Strasburg, Hagë...  
thirrjen e tim biri  
sipas pentagramave me nota londineze  
e pagëzokan me nofkën  
blasfemi!?

s'paska Zot, as Perëndi!

## ARMIQTË

ju ka ndërsyer lakmia  
ndaj gjinjve vashërorë të fushave tona  
ndaj shtatit belhollë të pyjeve tona  
ndaj zemrës sonë të madhe  
gatuar me  
bukë e  
kripë

armiq, ne do t'ua lëmë të gjitha  
hithrat florë e faunë  
urat në bel të këputura  
mnelat e ecjes sonë përpara  
varret pa emër e histori  
as zog  
as korb

e do t'u godasin  
rrufetë e urrejtjeve tona  
shiu  
bora  
tërmetet  
sëmundja metuzalem

ciklopi i pendimit do t'u kafshojë  
me nofullat e veta vigane  
pastaj ju do të komandoni - prapaktheu!  
por, kthim s'do të keni  
sepse, toka jonë  
do të bëhet varri juaj.

## VALLJA DYSHE E SHEKULLIT XXI

varret e strëgjyshërve po m'i rrëmoni  
nëpër skica, projekte, eleborate...  
emrin tim po e lakoni  
sipas rasave, vetave e gjinive  
të gjuhëve të huaja, kentum e satem

nëpër kasafortat e kancelarive  
të Hagës, Brukselit, Gjenevës, Londrës  
tokës sime po ia vizatoni  
qiellin pa yje e pa diell

titërrimin e hënës mbi Dukagjinin engjëllor  
po e mbuloni me luftën polare  
e nipit tim të lidhur në shpërgenj  
ninullat mortore po ia këndon

në liturigjtë mbajtur në tempujt tuaj modernë  
orvelliançe vdekjen time ringjallje po e pagëzoni  
kryqe e sakramente sllave  
te kasolla ime po rrapëllijnë

por unë gjallë se gjallë  
herë ilirisht  
herë arbërisht  
në skenën e shekullit XXI do të hyj  
me vallen dyshe  
të luajtur shqiptarçe

## DO TË NGRIHEMI SËRISH

ne do të ngrihemi sërish  
mbi gërmadhat e ëndrrave tuaja  
demoniake

mllëfit tuaj katil  
dhemb e dhëmballë do t'ia nxjerrim  
le të ngordhë urie  
te porta e Shekullit të Ri  
përtej Gurit të Shpuar

lakminë tuaj aziate  
në gropë coftinash do ta varrosim  
as korbant  
as hienat  
të mos e gjejnë dot

ne do të ngrihemi sërish  
mbi plagët e brishta të kufomave tona  
mbi muranat e lashta të eshtrave ilirikë

## EMRI IM I PAVDIRË

Ilahtarshëm po pëllet urrejtja pranë kasolles sime  
u thinje me durimin urtak në parzëm  
o populli im! Robinson Kruzo në ishullin e Evropës  
Miss Universum i Aparteidit  
zgjedhur në lozhat e masonëve  
të të dhjamosurve senilë

përbindëshi i makthit po ta kafshon lavdinë  
në varre heronjtë e fisit mornica të ftohta po i kaplojnë  
o populli im, ndërgjegje e mjegullt e Evropës  
Miss Universum i Robërisë  
zgjedhur nga jashtëqitja trunore  
e fundshekullit XX

o populli im i pavdirë!

## KOPILAT E ADAMIT

nga Albakosburgu i Evropës së Jugut  
orë e çast mbushen përplot  
autobusë, trena, avionë, anije...  
ia mësyjnë kristofor kolombot modernë  
reth e përqark globit tokësor  
gjakojnë zbulimin e kontinentit të panjohur  
të azillandit

në këtë udhëtim të pafund  
gratë shtatzëna lindin  
hapësirave pa juridiksion shtetëror  
çertifikatat e fëmijëve të tyre  
në vend të rubrikës "Qyteti", "Shteti"  
kanë të shënuar korridorin fluturues  
apo shkallën e navigacionit  
dhe emrin e nunit të panjohur  
kapitenit të ekuipazhit

nëpër aeroporte, stacione trenash, porte detare...  
në Evropë, Amerikë, Australi...  
gjuhë e dytë është bërë ilirishtja e re

e flasin mërgimtarët  
pa të drejtë kthimi në vendlindje  
mysafirët e tyre  
halabakët  
dashnoret e tyre  
burrat pleq  
gratë analfabete  
fëmijët, pa çerdhe fëmijësh

ilirishtja bukolike  
në vetmi i bie fyellit të vet baritor  
rrokaqijeve marramendës të metropoleve  
të botës së  
hiçit

kopilat e Adamit  
dhe të Ev(rop)ës kurvë  
të mohuar  
dje  
edhe sot?



## DHUNIMI I SHËN PAQES VIRGJËR

maramenthi duke u sjellë rreth natëditës së vet  
shekulli plak në prag të vdekjes  
mendueshëm e mban kokën me dy duar, dhe  
dëgjoka fjalën e shenjtë paqe  
nga lahutari i verbër homerian  
nga i drejti Hamurab, luftëtari Atila  
faraonsulltani, Hitler - Stalini  
kryerrenci botëror Bush - Jelcini  
lexoka në Bibël e Kuran  
në Kartën e Ligës së Popujve dhe të O K B-së  
në rezoluta e nota diplomatike  
në marrëveshje të fshehta e publike  
në pakte e traktate...  
por, Shën Paqen askush s'e pa mbi dhe!?

në fundjetën e shekullit plak  
globin e pakunguar e kanë zënë ethet  
popujt këmbëzbathur po ikin  
nga gojëdhënat, përrallat...  
dhe po trokasin dyerve të përgjakura të historisë  
hapeni! jemi ne, abortët e paqes suaj  
të Rendit të Ri Botëror  
ne, fëmijët e durimit thinjosh  
bonjakët e flijuar pamëshirshëm  
në hartat gjeografike të Stalin - Çerçil - Rusveltit  
në Jaltë, Postdam, Maltë...  
zotërinj! të qetë s'do t'u lëmë kurrë  
zjarrin makbethian prore do t'ua ndezim  
bordeleve të Moskës, Parisit, Londrës, Vashingtonit  
juve, që mynxyrshëm e dhunuat Shën Paqen Virgjër  
ndjestë pastë!

## KASHË E LASHË

shpallje!

shpallen të hapura garat në shkallë kombëtare

nënat duhet të lindin sa më shumë fëmijë

për t'i plotësuar normat

e qelive sapo të ndërtuara

në Nish, Burrel, Idrizovë, Spaç...

këtu do të bëhet shkollimi makabër i njerëznumrave

sipas abecesë animaliste të Darvinit

në mbështetje të mësimeve tepër të shtrenjta

të të pavdekshmit faraon ballkanikusit, Tito - Enverit

përshtetjet revolucionare

Partia!

PS:

Tepër sekret! Nëna kini kujdes ndaj armikut klasor!

## LAJMET

ju flet Radio Komunizmi  
po i japim lajmet  
sot, pikërisht në orën 12,30, në kuotën 104  
me pjata fluturse arritën qeniet jotokësore  
ata lanë porosinë interplanetare -  
edhe ne i bashkangjitemi kërkesës gjithëpopullore  
që shoku Parti të emërohet Udhëheqës  
pa kufizim mandati  
për gjithë kozmosin  
kurse Zoti, si mbeturinë e ndyrë klasore,  
të shkarkohet menjëherë nga fronti  
kërkesa në Byro u miratua me aklamacion  
Tito - Partia! Parti - Enver!

Zoti u trishtua nga hija e vet

## KOSOVARI I MËRGUAR

e mori kosovari valixhen  
tre fëmijët e vet  
dhe u nis drejt Veriut

majtas ishte gremina,  
djathtas qe ngrehina e Agata Kristit  
prapa mynxyra e Drenasit të kësikohshëm \*

sapo zbriti në tokën e Premtuar  
fëmijët e gjeten kutinë e Pandorës  
dhe u mrekulluan

kosovari ngeli fill i vetem  
veç me Kosovën e tij  
në ëndrra

\* Kjo poezi u shkrua më 1991, kur në Drenas (ish Gllogofc) policia serbe i detyronte shqiptarët të hanë bar !!!

## DITË VERE NË DUKAGJIN

me govata uji në dorë  
engjëjt i shpërlanë xhamat e qiellit  
sa çil e mbyll sytë iu duk kërthiza vashërore  
kaltërimit

nallbani plak te lëmi i drunjve  
diellit ia mbathi patkonjtë me thumba rrezesh  
le të kalërojë, tha ai, horizonteve të pafund  
të Dukagjinit përrallor

tani hapekrah portat i çeli mëngjesi  
faqekuqe po hyn dita  
nusëruar me duvakun  
veror

pas pak trishtueshëm filluan të biejnë këmbanat e vapës  
mesditës i ra të fikët  
e demi i etjes po pëllet i harlisur  
shkumë për goje duke qitur

pasdite nisi t'i shterojë edhe gjiri  
nuses së murosur tek Ura e Fshejt  
gurë e drurë po i tundon vaji i kërthinit  
të cilin legjenda tashmë s'e mëkon dot

lart, në qiell drapri anemik i hënës  
e përgjëron farkëtarin e natës për pak gjak  
por, ai degdisur përtej Alpeve Shqiptare  
kotet

dikujt iu kujtuan falltoret evgjite  
ato në shuplaka dore i panë duke rendur  
krushqit e rinj, hipur mbi kuaj të reve  
shiun stolisur me ylber krahaqafë

më vonë, disa të halitur Zotit i fishkëlluan në vesh  
ai u tremb, nxitueshëm i lëshoi perdet e territ...  
ja, tani yjet e përgjumur po i fërkojnë sytë  
mbi Dukagjin

## LEKTISJE E PASHUAR

e bërë kruspull këmbë e krye  
hëna u rras nën jorganin e trashë të reve  
tash një vezullim paqësor  
i varet në qepalla

diku, përtej gjakimit fanitës  
natën kalldrëmeve të Dukagjinit  
trokun e gjokut të Ago Ymerit  
nusevejat e ëndërrojnë...

err e terr pranë kroit  
një nënë e verbuar nga rapsodi i baladës  
pret e përcjell kalimtarë buzëfshikur  
tim bir a s'ma patë?

i zënë rob nga nanurisja e përrallave hirplota  
ai kulmos çatinë e Sizifit  
derëzi

# **FOLE E DHEMBJES SË BUKUR**



## FRYMËZIMI

ti je ai qumështi vesor  
që ia shëron trëndafilin rrufën

ti je ajo aroma fanitëse  
pas së cilës luleve u bie të fikët

ti je ajo ninulla dukagjinçe  
që e vë në gjumë mllëfin katil

ti je ajo dritëhëna vezulluese  
që ua ndriçon shtigjet e errëta baladave

ti je ai duvaku i rrezeve  
që e nusëron prillin

ti je ajo shoka e ylbhtë  
që ia lidh ijet vjeshtës reumatike

ti je ai kaltërimi veror  
që e grish hënën të dalë lakuriq

ti je ai frymëzimi i hirtë  
që mbëlton yje në kopshte poezie

ti je ai, që hyn në zemër njëherë  
dhe, s'del kurrë më

## POEZI BIBLIKE

prej hiçit të fjalës sime  
dua të krijoj bukurinë biblike  
Even - Doruntinë

ia filloj me pak tokë e  
lule  
me pak shi e  
ylber  
me pak dritë e  
ëndrra

por, o Zot! sa e pakapshme qenka  
përsosmëria jote

## KRYEVEPRA E ZOTIT

ç'bënte Zoti kur po lindej Doruntina?  
në pikë të hallit paskësh rënë  
si ta ringjallë vetveten edhe njëherë  
e të mos jetë më as Zot  
as Krisht  
as profet  
gjakonte për të lënë kryeveprën e vet jetësore

mendoj, çmendoj, Pikason e thirri në ndihmë  
po, djallopunë,  
piktura iu duk tepër abstrakte

veçse, Zoti rastësisht nuk është Zot  
ai gjithçka në dorë të vet e ka.  
urdhëroi - të lindet vasha me emrin Doruntinë  
e të jetë më e bukur se ajo nga Kënga mbi Këngët  
e të ketë devotshmëri biblike  
dhe, marrëzisht ta dashurojë poeti

pikë për pikë ashtu u bë  
tani, Zoti plak me monokël në sy  
e shikon i mahnitur kryeveprën e vet madhore  
Doruntinën  
në Gatnik

## HYN GJARPËRI E DEL NUSE SHTATSELVI

nëse ka diçka në këtë botë  
që s'mund të përshkruhet kurrë  
ajo është bukuria jote

sytë e tu po të mos ishin  
agimi do të lindte i verbër  
e hëna kurrë s'do ta kish atë ngjyrë portokalli

nëpër unazën magjike të bukurisë sate  
hyn terri e del dritë e bardhë  
hyn shiu e del ylber i mrekullueshëm  
hyn rrezja e del buqetë trëndafilash  
hyn meteoriti e del yll polar  
hyn pikëllimi e del gëzim i harlisur  
hyn urrejtja e del zemërbardhë si dashuria  
hyn gjarpri e del nuse shtatselvi

pse thonë se në botë janë veç shtatë mrekulli?  
të tetën dhe më të bukurën e ka parë veç një poet  
tani i çmendur

## NJË LLOJ DRITE TJETËR

edhe njëherë i lexova poezitë e mia për ty  
befas më ra në sy se  
për së tepërmi i përmendkam yjet, diellin, hënën, ylberin  
(mbase jam frikësuar  
mos, vallë, brenda vargjeve të mia po të kaplon një hije terri!)  
sonete, në këtë poezi, s'do t'i përmend këto  
do ta gjej një lloj drite tjetër, të panjohur deri më tani  
që të llamburisë mbi këto udhë të gjata rreshtash  
gurë s'do të lë pa lëvizur, këtë dritë për ta gjetur  
po, vallë, si do ta gjejë unë, poeti?  
po më duket se rrugëdalje tjetër s'më ka mbetur  
veçse n'e marrsha emrin tënd  
Doruntinë

## AGON NË ËNDRRA

nuk është dashuri ajo  
nëse çdo natë ti nuk agon në ëndrra

nëse në labirintet më të shurdhëta të ndërdies  
nuk jehon prore zëri i largët i thirrjeve të tua

nëse pareshtur portreti yt  
nuk parakalon madhështor para tribunës së fantazisë

nëse mushkëritë e frymëzimit  
nuk frymojnë veç hirësinë tënde

nëse malli im për ty  
nuk ua ndal rritën mendimeve të tjera

nëse pikëllimin e pangushëlluar  
nuk e shëron kujtimi yt

## KALTËRON DET E QIELL

gjarpri i zi i vdekjes  
para teje vallëzon në majë të gishtërinjve, si balerinë  
harruar i ka të vegjëlit e vet të uritur në fole  
se më, mos o Zot!, të kafshojë ndokë  
hutuar e paskësh fyelli magjik i bukurisë sate -  
kraharori yt - hënë mes resh  
që prore e grish ujëvaren e epshit

sytë e tu kur shikojnë  
kaltërojnë det e qiell të turbullt  
yjeve u merren mendtë, pikojnë në prehrin tënd  
e i zë gjumi në pikë të ditës  
krojeve u thahet qiellza për një pikë ujë  
e bëjnë që memecët të ligjërojnë  
oratorëve t'u merret goja  
besfortëve jetikë t'u thyhen prangat e besës

ai që të ka parë qoftë dhe veç një herë  
vdes syhapur po s'të pa më  
ashtin s'ia kalb dot dheu

## ASKUND S'TË LËNË TË QETË

në planetet e tjera janë kurdisur plane të fshehta të të grabisin  
të shëmtuarit! duan ta fisnikërojnë racën e tyre të çoroditur  
gjysmëhëna skuqet, ul kokën e hidhëruar  
pse s'mund të lindë prore e plotë si ti  
qielli me ylberin e vjedhur të bukurisë sate  
ia lidh kordelet shiut flokëshprishur

në tokë, luleve iu pëlçet mëshikëza prej xhelozisë  
pse ato s'mund të zbukurohen si ti  
zogjve shkumë për goje u shkoka  
meqë aspak zërit tënd s'mund t'i gjasojnë  
piktorit i dridhet brusha në dorë  
kur portretin tënd e fillon

o, të gjithave ti ua paske marrë pahin!  
e, pra, jo Tanusha e kralit të Kotorrit  
por vasha e trëndafiltë, Doruntinë



## SYTË E TU

janë fole rrezesh  
yjeve ua ndezin dritat  
portë enigmatike  
ku lehtë mund të hyhet, por assesi të dilet

kur shikojnë  
lumenjtë zënë në thua, thyejnë qafën  
lisat e gjatë marrin qëndrimin - gatitu!  
Shën Mërisë i bie prej duarve në tokë Krishti i Vogël

kur buzëqeshin  
ndërtojnë ura të ylberta prej zemre në zemër  
ua shërojnë plagët luleve  
janë varr i pikëllimit

kur vajtojnë  
blerimi venitet  
sëmuren ylberët  
gjarpri i barnatores e kafshon në dorë Hygien

kur mbyllen  
dy hënëza në gjumin qiellor  
që ëndërrojnë përjetësinë

## LETRA

duhet hapur me magji  
të mos tremben gjithë ato që as nuk shihen, as nuk preken  
tajfuni i shqetësimeve që rreh brigjet e aortave  
vrapimi maratonik i gjakut  
aritmia e zemrës  
frymëmarrja që s'ngopet dot frymë

medet! magjia aspak nuk ndihmoi  
gjumin e goditi sëmundja e pagjumësisë  
rrëmujë përfytyrimesh  
tinguj të çoroditur mendimesh  
durimi u nevikos pamasë  
lakuriq, si i çmendur, vrapon rrugëve të qytetit

ja, tani, ngadalë, orkestra e germave  
ekzekuton valset e buzëqeshjeve të tua  
orteku i ankthit ikën me të katra prej kraharorit  
gëzimi organizon olimpiadë  
kujtimeve të ngrira nga harresa  
u ngrohen eshtrat

## DITË VERE

disa molerë të pa zanatë  
natën e paskëshin lyer qiellin me bojë të zezë, futë  
të tmerruar pastaj, pa gjurmë qenkan tretur  
zor se do të zbardhëllojë ndonjëherë!

u dashka flijimi i vashërisë  
u gjet një vashë shpirtmirë e tha: - Po!  
ja, tani, pa nunëri plakash qindravjeçare  
bardhësi tamblabore po lindë

mirëpo, siç po shihet, mëkat i madh qenka bërë  
ushujza e vapës sot pikën e gjakut s'po ua lë  
krojeve, lumenjve...  
madje, rrezik i madh është nga përmbytja apokaliptike  
Poli i Veriut dhe ai i Jugut të shkrihen tok  
ruana Zot!

o, ju, molerë të mrekullueshëm!  
ju lutem me përulësinë më të madhe  
kthehuni edhe njëherë!  
e lyeni veç një copë qiell mbi Gatnik, siç e lyet mbrëmë  
të mos m'i ndodh sot gjë e ligë  
Doruntinës

## NATË VERE

hëna ka veshur një fustan drite  
të kuq si epshi  
malet kanë rënë përmbys, po koten  
asgjë s'pipëtinë veç trokut të heshtjes  
gjithçka frymon qetësi të amshuar...  
po, vallë, në ç'pallate ëndrrash  
do të ketë hyrë sonte Doruntina?

## I DASHURUARI

ai kurrë s'është vetëm  
mikun më të mirë e ka kujtimin  
i kupton edhe gjërat, që të tjerët s'i kuptojnë dot  
i pëshpërit në vesh lules, peshkut, blerimit...  
lulëzon më bukur se vetë trëndafili  
eshtrat i ka të mbushura me ajr lumturie  
gjithësia është e vogël për fluturimin e tij të madh  
në qiell ka ndërtuar një fole të fshehtë  
ku i mbledh yjet si margaritarë  
gëzimi i tij ka ngyrë të ylbhtë  
ëndërron gjithmonë diçka të përkryer...  
veç zemrën kurrë mos ia kërkoni  
ajo ka herë rreh pranë zemrës tjetër

## BRENDA NJË DITE

në agim të kërkoj  
ti fshihesh nën vesën e harrimit  
(si trëndafil i paçelur në mëngjes)

në mesditë të thërras  
ti shpërndaresh në hapësirën e pafund të dritës  
(si mllefi në zemër)

dikur, natën vonë  
e yllëzuar më hyn në ëndërr

## SHPIRT HYJNOR

veç unë e di pse ndrin kaq shumë kjo dashuri  
emri yt, Doruntinë, i jep shpirt hyjnor \*  
imi përjetësi

---

\* Emri Doruntina vjen nga greqishtja - Dorotea,  
dmth. dhuratë e Zotit

## EDHE MË E BUKUR NË ËNDRRA

papritmas ardhja jote s'mund të vinte më dot  
pikëllimi mori ngyrën e limonit  
e, gjuha iu kthye atdheut të vet parahistorik, heshtjes  
o, po ti më qenke edhe më e bukur  
në ëndrra



## FOLE E DHEMBJES SË BUKUR

kthehu sërish në folenë tënde  
o dhembje e bukur!  
o dashuri mitare!

zemra ime është nuskë  
për ëndrrat hyjnore

## PA TITULL

hëna ka të ftohtë, po ngrin në kupën e qiellit  
ikën ajo vrap e struket mes rreshtave të poezisë sime  
pranë emrit tënd, Doruntinë, i ngrohet gjaku

## NJËSOJ E BUKUR

më mirë që s'u takuam  
yjet së afërmi s'e kanë atë dritë farfuritëse  
hëna është më e bukur në qiell se në cilëndo poezi  
por, qoftë larg, qoftë afër  
veç ti ma paske  
të njëjtën bukuri

## NJË DRITË QË S'FIKET KURRË

jam shumë i lodhur  
sytë po më dhembin nga pagjumësia  
duhet fjetur  
mbyll derën, shtrihem në shtrat  
një nga një po më fiken dritat e mendimeve  
po, një kurrsesi s'po më fiket  
kujtimi për Doruntinën

# **NJË ZOG PRORE E VAJTON**

## ASGJË PREJ QIELLIT

dy duar të ngritura lart  
nuk e përshëndesin diellin që e ka varë qafën në perëndim

as hënën që po përgatitet për të marrë fronin qiellor  
ato, asgjë s'kërkojnë prej qiellit

dy duar të ngritura lart thonë diç  
që me gojë kurrsesi s'mund të thuhet

piktor, o piktor!  
kurrën e kurrës s'ke për ta ditur  
se ç'bojë ka pikëllimi njerëzor

## XHELOZIA

kur ti e shikon qiellin  
sterrë me re u bëftë!

kur ti e shikon detin  
për ilaç ujë mos mbetë!

kur ti i shikon të tjerët  
vdekja më rri shumë afër

## KËMBANË MALLI

një këmbanë prore bie  
mosardhjen tënde ta zgjojë

një drenushë vrapon me kokën e ngritur në qiell  
pranë kroit e etur vdes

një zog pa çerdhe e fole  
vetmia e mbyt

në shkretëtirën e një zemre  
një banori të vetmuar vendi vend s'i zë  
malli për ty



## PRORE ME TY

unë nuk hidhërohem  
kur hidhërohem  
kur qaj  
unë nuk qaj

unë nuk jam vetem  
kur jam vetem  
kur të vdes  
unë nuk vdes

unë prore jam me ty  
madje, kur s'jam me ty

## AS NË TOKË AS NË QIELL

- tim vëlla, Kadrushit

- jo, or vëllai im, ti nuk je rrakatur, madje fort mirë je  
kjo është po ajo lagje, po ajo shtëpi, po ajo dhomë, po ajo  
kanape  
por, aty kurrë më s'do të më gjesh mua  
ka kohë që e kam ndërruar adresën  
nuk banoj më në kufomën e qenies sime  
e, tani sa para bën për ty, nëse e mëson vendbanimin tim të ri?

megjithatë, ja ku e ke kartëvizitën time  
as në tokë, as në qiell,  
rruga - zemra e Doruntinës  
pa numër

## FJALA JOTE

- shokut tim, Hazyr Dervishit

më virtuoze se vet Paganini  
kur i bie violinës së gëzimit pa asnjë tel

ma vë në gjumë si foshnjën  
dinosaurin e pikëllimit tim

vetmisë sime binjake  
lakun ia heq prej fytit

me shpejtësi drite mur kinez ndërton  
mllefin tim mongol e lë me gishta në gojë

jo rrallë, fuqishëm e mbanë për dore qenien time  
të papeshë, të paadresë

fjala jote  
e urtë

## GATNIKU

mes tokës e qiellit  
mes njerëzve e egërsirave  
mes fushave e pyjeve  
mes blerimit e venitjes  
mes territ e dritës  
mes të mirës e të keqes  
mes jetës e vdekjes  
mes premtimit tënd e mallit tim për Doruntinën  
ti shtrihesh aq i qetë  
o Gatnik i largët!  
o Gatnik i afërt!  
o varri im i hapur!

## DUA TË TË HARROJ

besën po ta jap se dua të të harroj  
as emrin më s'do ta përmendi  
pas vdekjes

## VJESHTA

diçka e tmerrshme po vjen  
gjethet cofët në tokë po bien  
e qielli po qan me ngashërim...  
le të ikin ata që mund të ikin  
unë po strukem në vegimet e mia për Doruntinën  
atje askush s'mund të më gjejë  
në këtë vjeshtë

## ZEMRA E POETIT

nuk është dritë çdo dritë  
hënë nuk është çdo yll

çdo lule nuk është trëndafil

s'është mall çdo mall  
dashuri nuk është çdo dashuri

vaj! për zemrën e poetit  
falur Doruntinës

## DASHURI POETI

të thash kur u ndamë  
kurrë më mos e dashuro poetin  
vishet pa shije  
mantelin vjeshtor në dimër  
vallëzimet e reja s'i di...  
ai di veç të dashurojë deri në vdekje  
dhe, asgjë tjetër



## MALLI

malli është dhembje pa pikë e presje  
nuk ndihmon as djepi i kujtimit më të ëmbël  
malli është dëshpërim vetullngrysur  
që s'di ku ta lësh vetveten për një çast  
është klithmë në shkretëtirën e vetmisë së pafund  
kujtim i diçkaje që s'kthehet më kurrë  
malli, për shembull, është kjo poezi për Doruntinën

## NË PLAZH

o, Zot! sa njerëz të rëndomtë ke krijuar  
i zhveshin rrobat në plazh  
rreziten në diell  
dhe, me zemra të akullta kujtojnë  
se po i ngroh dielli i lumturi së  
edhe pse kurrë në jetë pa s'e kanë  
Doruntinën

## NDARJA

ndarja është pamundësia apokaliptike  
toka poshtë e qielli lart  
zbulimi i kontinentit të panjohur të dhembjes  
përbirimi nëpër vesh të gjilpërës  
zemra e ndarë më dysh  
rënja pingul në vetvete  
pa asnjë gjurmë  
e varr

II

tani e pamundshmja duhet bërë e mundshme  
peshku duhet mësuar të jetojë në tokë  
e njeriu në ujë  
deti të jetë i cekët  
largësia të jetë e afërt  
foshnjat ta mësojnë alfabetin kinez  
kokrra e rrufesë të bëhet trëndafil

po të betohem se të pamundshmen do ta bëj të mundshme  
po, si do ta mësoj vetveten pa ty?  
Zotynë i Madh më ndihmoftë!

### III

po, ç'tu desh kjo punë  
o fati im i pafat?  
tani unë si do t'i zbres në tokë  
gjithë ato mendime për Doruntinën  
që vërtiten si kosmonautë në Gjithësinë e kokës sime?  
vallë, pse s'më lë në përditshmërinë e përhimtë të jetës  
gjuhën e së cilës e pata mësuar për mrekulli?  
vetë Zoti që është Zot zor se do ta krijonte botën sërish  
e lëre më unë, poeti, t'ia nis prej germës A kësaj bote pa ty  
Zotynë më ndihmoftë!

## E SHKRUAR ME GJAK

këtë poezi po ta shkruaj me gjakun tim  
ti kot do t'i bësh analizat spektrografike  
dashuria ime është shumë më e lashtë  
se sa ndarjet e gjakut në grupe A, B, O...

VETËM TI

pas çdo lindje të sërishme  
tmerrshëm prapë do të dashurohesha  
veç në ty

## TESTAMENTI

plotësisht i vetëdijshëm kam vendosur  
secilit t'ia lë hisen e vet  
nënës ia lë pikëllimin e pafund e të gjerë sa fushat e Kosovës  
vëllait dhembjen që s'do ta shërojë kurrë  
shokut vetminë e varrit  
Doruntinës  
poezitë



## EPITAF

kur të vdes, ju lutem mos më qani  
sytë m'i mbyllni, nëse të hapur ngelin  
le ta ëndërrojnë përjetë Doruntinën

## FATI IM

ijeve shëndetliga të jetës sime  
prore më godite me brirët tua  
o dem i zi!  
o fati im!

si shami e kuqe toreadori  
të është bërë kjo qenia ime  
o i uruar!

po të betohem se një ditë  
keq do të të mund  
në jetën time  
të Pasvdekjes

KROI

gurgullon  
rrjedh  
pikon  
kur t'i soset edhe pika e fundit e gjakut  
si engjell, padiktueshëm jep shpirt  
në kufomën e  
në varrin  
e vet

## ZOTIT

ata më të mençurit të dëbuan  
përtej qiejve  
përtej harrimit  
me vetminë e tmerrshme të dënuan  
po ti, tinëza u hakmerresh  
atyre që ende të besojnë

**NDËRGJEGJJA**

aq sa prej vdekjes  
askund s'po mund të ik  
prej gishtit tënd tregues

## KAH VDEKJA

paska rënë borë e madhe  
mbi vitet e mia  
e veç një shteg ma paska lënë  
kah vdekja

varrmihës, mos rrëmoni thellë!  
se e pat ajo: sot këtu e nesër Zoti e di se ku?  
tani kam kohë të ngathët, që s'plaket kurrë  
dhe me përkushtim do ta ndreq vetë  
varrin  
tim

## BALADË PËR POETIN

e kërkujnë në qiell e në tokë  
varr s'lënë pa shpluar  
por s'e gjejnë dot  
mbi plep të lartë të një balade  
një zog prore e vajton

# PASTHËNIE



## H A J D I N A B A Z I

**“Një lloj drite tjetër” është një surprizë e këndshme**

Përmbledhja poetike e z.Shefki Oseku, me titull “Një lloj drite tjetër” është një vepër letrare, e cila përveç fatumit rrugëhumbur shqiptar, ka edhe një dimension tjetër, atë personal. Në ciklin e parë me titull “Nënës” shohim paaftësinë tonë kolektive, dje dhe sot, në histori dhe bashkëkohësi. Ndjejmë atë fshikullim të kohënjerkës e cila padhembshëm na godet, na viktimos, dhe na bëjnë thërror ata që e kanë “dhunuar Shën Paqen Virgjër”:

popujt këmbëzbathur po ikin  
nga gojëdhënat, përrallat  
dhe po trokasin dyerve të përgjakura të historisë:  
hapeni! Jemi ne abortet e Paqes suaj!  
të Rendit të Ri Botëror  
ne, fëmijët e durimit thinjosh  
bonjakët e flijuar pamëshirshëm” (...)

Kështu shprehet autori në poezinë “Dhunimi i Shën Paqes Virgjër”. I tillë, tash dhe gjatë tërë këtij shekulli e më thellë në histori, është edhe populli ynë fatkeq, i cili është ai “bonjaku i flijuar pamëshirshëm” nga ata që i kishin dhe i kanë në duart e tyre fatet e të vegjëleve. Vargjet e mësipërme përveç se shprehin fatin e shumë popujve që e gjakojnë lirinë, janë edhe një realizim i bukur artistik, ku spikat talenti i z.Oseku për të na folur me gjuhë të figurave, me anë të të cilave na zgjon asociacione, përmes të cilave, pastaj, fluturojmë në krahët e imagjinatës dhe brenda kaq pak vargjeve përshkojnë një gjendje aq prekëse dhe të dhembshme-kamxhikun e robërisë me të cilin goditen popujt pa liri.

z.Oseku e fikson poetikisht edhe nekrologjinë e nënshtrimit të popujve të robëruar, të cilëve, ata të fuqishmit, ua shkruajnë

nëpër konferenca të quajtura me emra të ndryshëm, por që gjithnjë dirigjohen mistershëm nga interesa të padukshme. Këto interesa, për fat të keq, diktohen nga ata, detyrë morale e të cilëve është pikërisht mbrojtja e të vegjëleve e jo nënshtrimi i tyre nga të mëdhenjtë. Kjo dyfytërsi politike e tipit sui generis poetin e revoltonte dhe ai me ton protestues do të shprehet: "Orvelliançe vdekjen time–ringjallje po e pagëzoni!" ("Vallja dyshe e shekullit XXI").

Megjithëse me përkatësi evropiane, banor i kontinentit tonë të vjetër, populli ynë është aq i vetmuar, apo aq i mohuar sa z.Oseku me figuracion poetik krahasimtar e qanë: "O populli im! Robinson Kruzo në ishullin e Evropës" ("Emri im i pavdirë").

Në poezinë "Kopilat e Adamit" z.Oseku fshikullon të gjithë ata që e kanë marrë arratinë, që kanë braktisur vendin duke kërkuar iluzion-shpëtim, me emrin figurativ "aziland". Këtu nuk janë vetëm ata, por jemi të gjithë ne, së toku, unë, vet autori, ju, me një fjalë, të gjithë ne që kemi marrë rrugën e ikjes. Ne, kristofor kolombot modernë, që gjakojmë zbulimin e kontinentit të ri të azilandit. Këtu na del më e fuqishme se në asnjë poezi tjetër satira e z.Osekut. Kaq e rëndë është fshikulla sa që të gjithë ne, të gjithë mërgimtarët, duhet të ndjejmë dhembje. Përderisa Kolombo pavetëdishëm zbuloi kontinentin e ri, Amerikën, kolombot modernë, ne, mërgimtarët, zbuluam një kontinent, që unë do ta quaja një planet të ri, me emrin AZILLAND, ku edhe jemi edhe s'jemi, edhe jetojmë, edhe s'jetojmë, edhe jemi nën vargojt e paaftësisë, edhe i kemi "shpëtuar" fatit të hidhur të palirisë. Këtu kemi liri, por një liri që e kemi gjetur të gatshme, që e kanë krijuar të tjerët për vete, e ku ne kemi ardhur dhe ua kërkojnë hisen tonë!

Po kaq fuqishem, me kamxhikun e sarkazmës z.Oseku godet ish rendet komuniste, të cilat nga premtues të paqes barazisë dhe respektimit të ndërsjelltë, si trumpetohej gjithandej në propagandë, u stërkeqën në realitet, saqë u shndërruan në një

totalitarizëm, përballë të cilit vet njeriu ishte fare i parëndësishëm. Nga një rend shoqëror ku duhej të thyhej kulti, në vendet ish socialiste u krijua një kult Perëndie me emrin PARTI, të cilën z.Oseku e vë nën thjerrzën satirike. Të këtilla janë dy poezi: "Kashë e lashë" dhe "Lajmet". Nga kjo e fundit po shkëpusim:

me pjata fluturuese arritën qeniet jotokësore,  
ata lanë porosinë interplanetare:  
edhe ne i bashkangjitemi kërkesës gjithëpopullore  
që shoku Parti të emrohet udhëheqës  
pa kufizim mandati  
për gjithë kozmosin  
kurse Zoti, si mbeturinë e ndyrë klasore,  
të shkarkohet menjëherë nga froni.

Kështu, po e përmbylim ciklin e parë dhe po e hapim ciklin e dytë dhe të tretë. Që në poezinë e parë me titull "Frymëzimi" do të ndjejmë me të vërtetë dallgët e frymëzimit, lirizmin e vërtetë të autorit, ku ai i thyen skemat dhe bllokadat, kalon nga realiteti i hidhur e i padashur, në një sferë ndjesore ku z.Oseku realizon artin e vet poetik, për mendimin tim, më të arrirë artistikisht. Personazhi që do ta hasim më së shpeshti dhe thuaja i vetmi emër konkret, është Doruntina. Jo figurë e legjendës shqiptare, por një figurë e re, me emrin e trashëguar nga lashtësia si një ndërlidhje fatësh e brezash: e të djeshmes dhe të sotmes; një figurë e re, dhe gjithsesi me përmbajtje të re.

Doruntina, në radhë të parë, është simbol i dashurisë. Por, se për ç'dashuri është fjala, autori këtu na vë para një enigme. Nga dashuria konkrete, për t'u bërë edhe më e fuqishme, është mistifikuar me dashurinë e dështuar të Doruntinës, ose për Doruntinën, për t'u bërë kështu bartës i një dashurie shumë të fuqishme dhe frymëzim për jetën:

"nuk është dashuri ajo:  
nëse çdo natë ti nuk agon në ëndrra"

Aq e madhe është kjo dashuri, saqë autori, në poezinë "Epitaf" porosinë që të mos qahet për vdekjen e tij dhe kërkon që sytë të mos ia mbyllin, nëse të hapur ata i ngelin. Përse? Sepse dëshiron ta ëndërrojë përjetë Doruntinën.

Por Doruntina poetike e z.Osekut, për më tepër, është simbol i bukurisë. Është bukuria vet, të cilën autori do ta quaj "fyelli magjik i bukurisë", ose "qielli me ylberin e vjedhur të bukurisë sate". Bukuria e Doruntinës është "orquestra e germave që ekzekuton valset e buzëqeshjeve tua".

Kjo bukuri është paksa edhe e mistershme, magjepse, saqë autori shprehet se ajo të gjithave pahin ua ka marrë, e pra jo Tanusha e kralit të Kotorrit, por vasha e trëndafiltë-Doruntinë. Duke e përshkruar bukurinë e Doruntinës, autori më pas thotë:

nëpër unazën magjike të bukurisë sate  
hyn terri e del dritë e bardhë (...)  
hyn pikëllimi e del gëzim i harlisur  
hyn urrejtja e del zemërbardhë si dashuria  
hyn gjarpëri e del nuse shtatselvi.

Kjo bukuri në poezinë "Sytë e tu" e shprehur përmes shikimit të syve të Doruntinës, është aq e papërballueshme, sa që "lumenjtë zënë në thua-thyejnë qafën" dhe, për më tepër, "Shën Mërisë i bie prej duarve Krishti i vogël"!

Doruntina, kështu si simbol i bukurisë, është një qenie e cila të magjeps me frymëzim për jetën, të jep impulse të reja, shtytje, forcë dhe shndërrohet vetvetiu në një figurë që është sinonim i NJERËZORES, në kuptimin më të thellë dhe në dimensionin e ardhmërisë së kësaj fjale.

Kështu pra, përmbledhja poetike e z.Shefki Oseku me titull: "Një lloj drite tjetër" është një brum artistik i gatuar mirë dhe si vepër është mjaft e arrirë. Por, si mik i autorit dhe si krijues, nuk mund të mos e pohoj një fakt që e cënon pjekurinë e veprës. Është dukuri e rëndomtë te krijuesit e rinj që nxitojnë nga mosdurimi për ta parë sa më parë në jetë veprën e vet; kështu, edhe pse e ka nxjerrë në dritë veprën si një surprizë të këndshme, duke mos e krehur edhe cazë me krehërin stilistik, duke mos i hequr aty-këtu emfazimin, sidomos gabimet gjuhësore, vepra në fjalë padyshim se herë-herë dëmtohet ndjeshëm.

Le të jetë kjo një vërejtje miqësore dhe njëherit një nxitje që, në ndonjë ribotim të ardhshëm, autori t'i eliminojë ato që janë të tepërta dhe t'i korrigjojë ato që duhet korrigjuar.

Edhe një herë urime dhe pastë rrugë të mbarë vepra "Një lloj drite tjetër"!

---

PS. Punimi u lexua me dt. 27.09.1997 në Shoqatën "Besa" të Treleborgut, Suedi, ku edhe u promovua vepra: "Një lloj drite tjetër", e botuar ato ditë. Poashtu, ky punim u botua në revistën "Drita" nr. 17 / 97, që del në Treleborg, të Suedisë.

# ZEQIR RAMA

## Prezentim i një krijuesi modest

Ne të Radio Malmes, këtu në Suedi, radaksia e emisionit të kulturës në gjuhën shqipe, përherë jemi deklaruar për afirmimin e vlerave të njëmendta njerëzore, kombëtare dhe kulturore. Kjo është dhe do të jetë pikësnyimi themelor i luftës sonë të përhershme kundër dukurive të kiçit dhe shundit në letërsi dhe art. Në kuadrin e mundësive tona, do të bëjmë çmos që kurrë të mos korruptohemi nga dukuritë e atdhedashurisë së rreme dhe të politikës dyfytërëshe. Gjithashtu ne, punonjësit e kësaj Radioje, nuk jemi indiferentë edhe ndaj vlerave mediokre, të cilat kanë zënë të na ngulfatin.

Askush nuk është kursyer nga kritika jonë parimore, as që do të kursehet në të ardhme. Posaçërisht e kemi goditur dhe do ta godasim një taraf gjysmëshkencëtarësh, gjysmëshkrimtarësh dhe gjysmëpoetësh, të vetëquajtur. Këta snobë të shkencës dhe të kulturës shqiptare, në bashkëpunim me disa çakej të shkathët dijnë t'i bëjnë vetes reklama të shëmtuara, në mungesë të institucioneve të mirëfillta kulturore. Kështu, për shkak të vizioneve tona të turbullta, lansohen dhe afirmohen pseudovlera, të cilat, për fat të keq, e ndërtojnë një godinë antikulturore, një jetë efemere dhe, gjithsesi, të kobshme për vetëdijen tonë kulturore, edhe ashtu mjaft të varfër.

Në këtë kaos kulturor po nxitojnë veçmas disa xhambazë të odave e të konferencave, që të promovojnë vepra. Këta, duke iu frikësuar së ardhmes, e cila do të jetë e ashpër për të gjithë, e sidomos për këta, po vrapojnë pas famës për të bërë emër në lëmi të caktuara. Këta po harrojnë se, të gjitha veprat dhe vlerat e vërteta kulturore e njerëzore do të seleksionohen në sitë të hollë, dhe do të vendosen aty ku e kanë vendin e merituar.

Në këtë situatë absurde ndodh që autodidaktët apo analfabetët të bëhen shkencëtarë; ideologët e dështuar të bëhen poetë e

publicistë; këngëtarët e shoqatave të shkruajnë romane!? Kulmi i tragjedisë për kulturën shqiptare është kur mu këta bëhen reprezentantë të kësaj kulture! Kështu, në sytë e botës na e prezantojnë krijimtarinë tonë kombëtare me vlerat e saja më të ulta, madje pa mesazhe elementare. Madje, nën agresionin e këtyre vandalëve kulturorë, pushtohet hapësira për veprimtarinë e denjë kulturore dhe afirmimin e vlerave të njëmendta. Kjo çështje ka arritur në atë shkallë, sa që krijuesi jonë i mirëfilltë marginalizohet dhe jeta e tij shndërrohet në një burg të anonimusit.

Krijuesit e mirëfilltë kanë edhe telashe tjera: ata u nënshtrohen edhe shumë ndërskamcave që iu bëhen pandërprerë në jetën publike dhe shoqërore. Ne, qëllimisht nuk do të lëshohemi në atë moçal, ku gugasin bretkosat antikulturore. Ne kemi bindjen se kultura e një populli pasurohet vetëm me krijues e me talentë të mirëfilltë e jo me autodidaktë që krekosen. Mu për këtë, ne nuk jemi të lidhur me qarqet burokratike të kulturës shqiptare, por me krijuesit modestë, që kanë sens dhe afinitet të lartë krijues, e të cilët edhe janë viktimat e këtyre dukurive që i cekëm më lartë.

Pra, radhën sot e ka një krijues i denjë, por modest, z.Shefki Oseku, i cili këto ditë e botoi përmbledhjen poetike me emër mjaftë simbolik: "Një lloj drite tjetër".

Në poezinë me titull "As në tokë as në qiell" (këtë poezi ia kushton të vëllait) letërnjohtimin e vet poeti e përshkruan me këto fjalë:

"ka kohë që unë e kam ndërruar adresën  
nuk banoj më në kufomën e qenies sime.  
e, tani, sa para bën për ty, nëse e mëson vendbanimin tim të ri?  
megjithatë, ja ku e ke kartëvizitën time:  
as në tokë as në qiell  
rruga: zemra e Doruntinës  
pa numër."

Nga poezitë e këtij krijuesi të talentuar, kuptojmë se ato linden në periudhën e traumave dhe frustacioneve individuale dhe kolektive, ku paradokset dhe kundërthëniet ishin karakteristike themelore e kohës dhe e shoqërisë së cilës i përket edhe autori.

Krejt e natyrshme është që një krijues të jetë herë i rezignuar, herë i ngrysur, e herë-herë pesimist. Aq më tepër kur hapësira ekzistenciale rrudhet në kufinj të biologjikë dhe kur dinjiteti njerëzor e kombëtar poshtërohet nga soji më i fëlliqur i një race barbare. Në këto rrethane jeta e autorit ishte plot dhembje, mallkime e ofshamë, të cilat njeriun e provokojnë deri në dilemën tashmë të njohur të Hamletit. Mirëpo, megjithatë, z.Osekun e mbanë shpresa e përjetësisë dhe e ringjalljes promethiane.

Ajo që kurrë s'e lë të qetë poetin, është gishti tregues i ndërgjegjës kombëtare që e detyron të kacafytet prore me të pamundurën. Pra, përndjekjet nga gishti tregues i ndërgjegjës së lënduar kombëtare janë më të padurueshme se përndjekjet nga forcat brutale të shtetit më diktatorial.

z.Oseku vuan edhe nga një dihotomi e shpirtit të tij. Nga shpirti poetik dhe nga vetëdija historike, të cilat e kundërshtojnë njëra-tjetrën. Vetëdija e tij historike nuk është ndërtuar me kopalla, përralla të shpirtngushtëve romantikë, por përmes gjykimeve të gjata; përmes kanaleve të diturisë moderne dhe shkencore, ku e vërteta del e qartë por, në disa momente, edhe e dhembshme dhe vetëvrasëse. Mu poezia e shpëton autorin që të mos vdes nga e vërteta shkencore. Sot, vërtet, njeriu nuk mund t'i bëjë ballë kësaj kohe të mbarsur me rrena e demagogji, ku ardhmërinë e kemi ngujuar në qindëra opzione e hipoteza utopiste.

Përmbledhja e poezive "Një lloj drite tjetër" është e ndarë në tri tërësi kuptimore, të cilat vet autori i ka emërtuar: "Nënës", së cilës gramatikanët marroqë ia kanë vënë shumësin; "Fole e



dhembjes së bukur", ku është e justifikuar sakrificat deri në vetëflijim; "Një zog prore e vajton", ku shihet qartë vaji dhe nostalgjia e poetit.

Kësaj nëne martire gramatikanët marroqë ia shkëputën fëmijët dhe ia morën nusen. Krushqit qyqarë assesi s'po mund ta rikthejnë nusen (lirinë) e rrëmbyer për ta martuar me të birin e tyre të hasretit, Shqipërinë Etnike (Rexhën).

Do të ishte i thjeshtë dhe tejet monoton poeti që e trajton veç një çështje, sado interesante të jetë ajo. Spektri i gjerë i temave është dëshmi e kulturës dhe talentit krijues, talent ky që nuk i mungon z.Oseku. Kjo gjë mund të provohet nga leximi sadopak i vemendshëm i përmbledhjes së tij. Kështu, ky ka dituri të saktë mbi Rendin e Ri Botëror, në të cilin krushqit shqiptarë me flamur të bardhë të paqes dëshirojnë ta bëjnë me nuse Shqipërinë. Por, Shën Paqeja Virgjër e shqiptarëve po dhunohet nga masonët senilë e të dhjamosur. Autori na e përkujton se flamuri i bardhë dhe Shën Paqeja Virgjër nuk janë karakteristikë për këtë shekull të stërngarkuar me konferenca e luftëra, të cilat po përfundojnë me gjenocide e spastrime etnike, me ekzoduse të papara ndonjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Ky ekzodus e ka prekur thellë edhe popullin tonë. Kjo gjë mund të merret edhe si parashenjë e zhvendosjes së qëllimeve: në vend të rezistencës, e kemi zgjedhur rrugën e ikjes!? Këtë dukuri tejet tragjike të këtyre ditëve, z.Oseku e ka parë me gjenialitet krijues. Pikërisht, duke u nisur nga kjo, poezinë "Kopilat e Adamit" mund ta quajmë antologjike, si për nga transponimi artistik i një plage të rëndë kombëtare, ashtu edhe për nga dhembja e mesazhi që kjo poezi përmban në vetvete.

Autori tragjedinë tonë më të re e përshkruan me këto fjalë:

"nga Albakosburgu i Evropës së Jugut

orë e çast mbushen plot  
autobusë, trena, avionë, anije...  
ia mësyjnë kristofor kolombotë modernë  
rreth e përçark globit tokësor  
gjakojnë zbulimin e kontinentit  
të panjohur të azillandit.  
në këtë udhëtim të pafund,  
gratë shtazëna lindin  
hapësirave pa juridikcion shtetëror,  
çertifikatat e fëmijëve tyre  
në vend të rubrikës "Qyteti", "Shteti"  
e kanë të shënuar korridorin fluturues,  
apo shkallën e navigacionit  
dhe emrin e panjohur të nunit,  
kapitenit të ekuipazhit."

Pjesa e dytë e kësaj përmbledhjeje titullohet "Fole e dhembjes së bukur". Ky cikël është pasqyrë e dhembjeve dhe e nostalgjisë për vendlindjen e bukur. Në këtë pjesë hetohen gjurmat e romantizmit bukolik të kohës së djalërisë, por mesazhi, megjithatë, është i qartë. Njeriu meriton të flijohet dhe sakrifica s'është e pajustificueshme, aq më tepër, kur kjo bëhet për trollin tonë të pasur, në të cilin pasardhësit mund ta ndërtojnë një lumturi dhe ardhmëri të qytetëruar. Bukuria të cilën e gjakon poeti s'gjendet askund tjetër, pos në atë troll, ku jeton në pranga një popull fisnik, por i pafat në histori.

Pjesa e tretë, të cilën z.Oseku e ka emërtuar "Një zog prore e vajton", e simbolizon vet fatin e autorit, i cili tani jeton buzë një deti të ftohtë si akull, i rrethuar me injorantë, të cilët i përngjajnë kufomave të gjalla, që janë të zhveshur nga çdo ndjenjë fisnikërie për njeriun dhe atdheun.

Në vjershën e tij pikëlluese "Kah vdekja" poeti shprehet:

"varrmihës, mos rrëmoni thellë!  
e pat ajo: sot këtu e nesër, Zoti e di se ku?  
tani kam kohë të ngathët, që s'plaket kurrë  
ndaj, me përkushtim do ta ndreq vet  
varrin  
tim."

Vargjet e z.Oseku janë moderne, ngase në to nuk ka dekor të tepruar, sentimentalizëm të papërmbajtur, folklorizëm banal, retorikë të zbrazët dhe sofistike të mërzitshme. Poezitë e këtij poeti janë gurrë prej së cilës njeriu mund t'i shijojë idetë e qarta, të cilat, pastaj, na mundësojnë një vetëdijësim dhe mobilizim të energjive njerëzore dhe kombëtare, për të dalë nga një moçal idesh dhe drejtimesh, tashmë fare të tejkaluara.

Nëse lexuesi e lexon këtë përmbledhje me përkushtim, nuk do të ndahet nga këto poezi pa e ndjerë një katarzë dhe lehtësim shpirtëror, po edhe një krenari për faktin se, një shqiptar në ekzil, na ofroi, vërtet, diçka të bukur dhe të mençur në këto çaste të rënda për kombin tonë.

Në fund, mund të them se, z.Oseku, edhe pse i lodhur nga jeta prometheike, megjithatë, ai e gjenë shpresën e përjetësisë, ndaj dhe në mënyrë vizionare e porositë kombin që të mos dorëzohet, por ta vijojë edhe më me ngulm luftën e shenjtë kundër armiqëve tonë shekullorë. Poeti është thellësisht i bindur se shqiptarët, një ditë, patjetër do t'i mundim hijenat e këtij shekulli, armiqët tonë. Dhe kjo, përkundër plagëve të panumërta dhe varreve masive, të cilat na i kanë hapur.

Ja, se si në poezinë vizionare "Do të ngritemi sërish" z.Oseku e parashikon fitoren mbi armiqët gjakatarë:

"ne do të ngritemi sërish  
mbi gërmadhat e ëndrrave tuaja  
demoniake

mllëfit tuaj katil  
dhëmbë e dhëmballë do t'ia nxjerrim  
le të ngordh urie  
te porta e Shekullit të Ri  
përtej Gurit të Shpuar

lakminë tuaj aziate  
në gropë coftinash do ta varrosim  
as korbat  
as hijenat  
të mos e gjejnë dot"...

Le të shpresojnë se kjo ditë e amshuar, të cilën z.Oseku e  
ëndërron, nuk do të jetë e largët!

---

PS. Punimi u lexua në Radio Malme, emisioni i kulturës në  
gjuhën shqipe, më 03.06.97. I njëjti punim u lexua me dt.  
27.09.1997 në Shoqatën "Besa", të Treleborgut, Suedi, ku edhe  
u promovua vepra "Një lloj drite tjetër", e botuar ato ditë.  
Poashtu, ky punim u botua edhe në revistën "Drita" nr. 14 / 97,  
që del në Treleborg të Suedisë.

# R I Z A S H E Q I R I

“Një lloj drite tjetër” - është fryt i pjekur poetik

Këto ditë z.Shefki Oseku iu prezentua lexuesve shqiptarë me një përmbledhje me poezi të titulluar “Një lloj drite tjetër”, e cila ndahet në tre cikle: “Nënës”, “Fole e dhembjes së bukur” dhe “Një zog prore e vajton”. Këto cikle për nga motivet që trajtojnë me një lidhmëri e kompaktësi përbëjnë një tërësi-librin mbi Atdheun, Dashurinë dhe Mërgimin. Pra, këto janë tri preokupimet, apo motivet kryesore në të gjitha poezitë e z.Shefki Oseku.

Çdo poet a shkrimtar, synim kryesor e ka që për preokupimet e tij të komunikojë me lexuesin, në mënyrën e tij origjinale, duke e bërë atë që lexuesi sa më mirë dhe sa më thellë të hyjë në botën e tij shpirtërore e artistike, ta përjetojë sa më shumë e sa më mirë fjalën e tij me të bukurën e saj.

Një qëllim të tillë shihet se i ka vënë përpara vetes edhe z.Oseku, me përmbledhjen e tij “Një lloj drite tjetër”. Poeti duke u vënë në kërkim të një lloj drite tjetër, na flet me të bukurën, artistiken e poezisë së tij që, në të vërtetë, është ai lloj tjetër i dritës së vargut e poezisë së tij, poezi kjo që padyshim është fryt i pjekur poetik. Prandaj, si fryt i pjekur poetik, poezia e z.Oseku “gëlltitet” lehtë dhe ka shije e lezet të plotë.

Këtë ndjenjë do ta përjetojë padyshim secili lexues, posa të hyjë në botën e pasur poetiko-artistike të kësaj përmbledhjeje me poezi. Sepse, çdo fryt i pjekur mirë ka shije të mirë, prandaj edhe shija artistike e këtij fryti të pjekur poetik të z.Oseku e kënaq lexuesin që ka etje për të bukurën e fjalës. Kur e themi këtë mendim i kemi për bazë poezitë që na janë prezentuar në përmbledhjen: “Një lloj drite tjetër”, pjesa dërmuese e të cilave, vërtet, janë të latuara e të goditura mjeshtrisht, sipas një shije të hollë të një mjeshtri të fjalës. Fjala këtu është gëdhundur e

stërgdhendur deri në atë masë sa del në pah fuqia magjike dhe mrekullia e saj.

Prandaj, poeti përmes poezive të tij komunikon me lexuesin dhe tek ai e zgjon ndjenjën e përjetimit emocional dhe artistik. Bie fjala te poezia "Kopilat e Adamit", ku mes tjerash ai thotë:

"gratë shtatzëna lindin  
hapësirave pa juridikcion shtetëror  
çertifikatat e fëmijëve të tyre  
në vend të rubrikës "Qyteti", "Shteti"  
e kanë të shënuar korridorin fluturues,  
apo shkallën e navigacionit  
dhe emrin e nunit të panjohur  
kapitenit të ekuipazhit."

Këta janë kristofor kolombot modernë nga Albakosburgu i Evropës së Jugut, të cilët gjakojnë zbulimin e kontinentit të panjohur të azillandit. Pra, është kjo ironia e fatit të mjerë e shumë shqiptarëve që detyrohen të marrin rrugën e mërgimit, ngase në atdhe u është mohuar gjithçka. Ja, pra, pse poeti i quan këta kopilat e Adamit dhe të Ev(rop)ës kurvë, të mohuar dje dhe sot!?

Ky shqetësim i poetit nga kjo dhembje e madhe që kullon gjak, ky mallë mërgimtar që ndezë flakë, është preokupim i autorit edhe në disa poezi të tjera, nga të cilat do ta veçonim poezinë "Kosovari i mërguar", ku z.Oseku me fare pak fjalë, duke i vënë ato në raporte të caktuara njërën me tjetrën, krijon imazhin e vetmisë, dhembjes dhe të ndjenjës së mallit e të atdhedashurisë te kosovari i mërguar, i cili edhe pse i mbështjellë nga kuçedra vetmi, në dhe të huaj, edhe pse fillkat vetem, megjithatë, ai gjithmonë është "veç me Kosovën e tij në ëndrra", sepse ajo është dashuria e tij e parë dhe e fundit.

Pra, brenda fjalës, të bukurës, të madhërishmes, poeti s'do të ndalet kurrë duke kërkuar një lloj drite tjetër, një lloj bukurie

tjetër, një lloj dashurie tjetër. Ai është i vetëdijshëm se fuqia dhe bukuria e fjalës janë të paskajshme, të pafundme dhe, mu për këtë ai vëhet në kërkim të bukurisë së fjalës dhe është i sigurtë se:

"do ta gjej një lloj drite tjetër, të panjohur deri më tani  
gurë s'do të lë pa lëvizur këtë dritë për ta gjetur"

Si shihet poeti i ka vënë për detyrë vetes që ta hulumtojë deri në fund dhe ta gjejë të bukurën e fjalës e me të, pastaj, të komunikojë këndshëm e ndjeshëm me lexuesin.

Mendoj se cikli "Fole e dhembjes së bukur" e ndezë për mrekulli ndjenjën e përjetimit intim psh: në vargjet e poezisë "Natë vere":

"hëna ka veshur një fustan të kuq si epshi  
malet kanë rënë përmbys, po koten...  
po, vallë, në ç'pallate ëndrrash  
do të ketë hyrë sonte Doruntina?"

Ose në poezinë "I dashuruari":

"gëzimi i tij ka ngjyrë të ylbertë  
ëndërron gjithmonë diçka të përkryer...  
veç zemrën kurrë mos ia kërkoni  
ajo ka herë rrah pranë zemrës tjetër"

Si po shihet pra, kemi të bëjmë me një lirizëm të këndshëm, të lëruar nga një pendë e zhdërvjellët dhe mjeshtrore. Kjo shihet veçmas te "Dashuri poeti":

"të thash kur u ndamë  
kurrë më mos e dashuro poetin  
veshet pa shije  
mantilin vjeshtor në dimër  
vallëzimet e reja s'i di...  
ai di veç të dashurojë deri në vdekje

dhe, asgjë tjetër”

Kështu do të shprehet poeti në poezinë tjetër "Dashuri poeti" që, krahas poezive "Hyn gjarpër e del nuse shtatselvi", "Sytë e tu", "Letra", "Natë vere", "I dashuruari", "Një dritë që s'fiket kurrë", e ndonjë tjetër, janë nga lirikat më të bukura të përmbledhjes me poezi "Një lloj drite tjetër" dhe, si realizime artistike, sipas mendimit tim, do të bëjnë jetë në kohë.

Ndërsa, sa i përketë cikleve në tërësi, më të realizuar do ta veçoja ciklin "Fole e dhembjes së bukur".

Nga e gjithë kjo që u tha del se puna kërkimore e poetike e z.Oseku, në kërkim të së bukurës, të madhërishmes, kurorëzohet me sukses në librin e tij të parë me titull "Një lloj drite tjetër".

Kjo vepër, vërtet, është një lloj drite tjetër e fjalës së bukur artistike që të bën për vete, që të ngacmon ndjenjën, të emocionon e të josh ta shijosh e ta përjetosh atë, veçanërisht disa nga lirikat e dashurisë që na janë prezentuar në këtë përmbledhje.

"Një lloj drite tjetër", edhe pse është libri i parë i autorit, kjo përmbledhje është fryt i pjekur artistikisht e poetikisht, shija e të cilit s'harrohet shpejtë as lehtë.

Kjo na bën të shpresojmë se poeti është premtues.

---

PS: Ky punim më 27.09.97 u lexua në Shoqatën "Besa", në Treleborg - Suedi, ku edhe u promovua përmbledhja "Një lloj drite tjetër". Poashtu, ky punim u botua në revistën "Drita" nr. 17 / 97, që del në Treleborg të Suedisë.



## ULMAR KVIKU

“Një lloj drite tjetër” është një nxitje për mëtim

Për lexuesin mesatar suedez, qoftë ky mashkull apo femër, që ka ose jo njohuri mbi poezinë, përmbledhja e poezive “Një lloj drite tjetër” është një nxitje për mëtim dhe ndiesi. Kjo përmbledhje fillon me afro njëzet vjersha, të cilat e kanë për lajtmotiv fatin e popullit shqiptar si dhe marrëdhëniet e tij me botën. Shefki Oseku me poezinë së tij don ta bëj të ditur botërisht se populli i vet ka qenë viktimë e mohuar, e amputuar, e masakruar, e pambrojtur dhe e dëbuar apo e asimiluar gjatë këtyre 120 vjetëve të fundit.

I frustuar dhe eksploziv, shkrimtari në këto poezi i anatemon armiqët dhe ata që e kanë tradhëtuar popullin e tij. Kjo nuk është tipike për Suedinë e sotme, ndaj ne duhet t’i referohemi të kaluarës sonë – Haidestamit (poet romantik suedez - vërejtje e përkthyesit!), në mënyrë që të gjejmë tone të ngjajshme në literaturën suedeze. Shpirti ynë pajtimtar nuk e pranon urrejtjen e pafre dhe mbamendjen e së keqes.

Pothuajse njëqind vite më parë, kur Fuqitë e Mëdha e gjymtonin kombin shqiptar duke i vënë kufinjte - trojet shqiptare u futën nën sovranitetin e shtetit të ciptuar të Shqipërisë, por, edhe nën atë të Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë, si dhe brenda kufinjve të Greqisë – gjë që prore hedhë hije ndaj politikës dhe jetës shoqërore në Ballkan.

Ende nuk janë plotësuar parakushtet që plaga të shërohet. Dhe, një nga këto parakushte të rëndësishme është drejtësia si dhe marrëdhëniet e barazisë mes të gjithë popujve e kombeve të Ballkanit. Pikërisht kështu zhduket urrejtja, racizmi, diskriminimi, dhe mosbesimi. Atëbotë edhe kufinjte do ta humbisnin rëndësinë e vetë. Por, fatkeqësisht, për të arritur deri atje - rruga është tepër e gjatë.

Vështrimi politik dhe njerëzor i Shefki Oseku është i ngjyrosur edhe nga përjetimet e tija tejet personale - nga tortura dhe keqtrajtimi policor, ndaj të cilave ky ka qenë i ekspozuar që në moshën e vet rinore.

Shkrimtari e pasqyron dhembjen, por kur kemi të bëjmë me të ardhmen e popullit të tij - kjo nuk mund të nënkuptohet si kapitulum. Ai, në të vërtetë, është optimist, përkundër të dhënës se në poezinë e tij shfaqet një mosbesim i plotë ndaj veprimeve të Fuqive të Mëdha, para së gjithash për hipokrizinë dhe tradhëtinë e tyre ndaj të drejtës së popujve dhe nevojave të tyre për liri, e cila do të ishte, vërtet, e denjë për emrin e vet.

Por, megjithatë, Shefki Oseku ka kapituluar - në planin e pastër personal. Në pjesën tjetër të përmbledhjes me poezi pasqyrohet ndjenja e fuqishme kënaqësisë e cila përjetohet gjatë dashurisë si dhe plagët e mëdha që më vonë i shkakton kjo. Në këto poezi dashuria shtegton udhëve të veta, në mënyrë të pakuptueshme dhe të paparashikueshme, deri tek përfundimi i vet i pashmangshëm. Dhe pikërisht këtu ka kapituluar poeti, para atyre forcave, ndaj të cilave asnjë luftë nuk është e mundur. Por, dashurisë së tij ky ai ka ndërtuar një përmendore në poezi.

Ai që i falë pak kohë leximit të kësaj përmbledhjeje poetike, nuk mund të jetë indiferent ndaj saj. Parakushtet për ne në Skandinavi që ta kuptojmë këtë poezi në të gjitha përmasat, janë shumë të vogla. Por, nga ky mozaik i pasur mund të merr shumëçka ai që e lexon pa paparagjytime. Dhe poezia – nëse vërtet është poezi – do të thotë sfidim.

Norrköping, më 20 mars 2003

Ulmar Kvik

PS. Parathënie e librit "Njëlloj drite tjetër" i cili në përkthim të Ullmar Qvikut u botua në mars të 2003, në dy gjuhët, shqip - suedisht.

## ROSEMARI SHULAKU

Pëmbledhja e poezive "Një lloj drite tjetër" e himnizon Kosovën Shkrimtarin e përshkon dashuria për popullin e tij, ndaj këto mbresa të pashlyeshme ai i ruan të gjalla, prej vitit 1989, që kur ka emigruar në Suedi. Gjuhëtari dhe juristi i angazhuar, në vitin më 1997 e botoi pëmbledhjen në fjalë, para se ta botonte romanin e tij Hetimet (në vitin 2000). "*Unë jam Robinson Kruzo në ishullin e Evropës*", thotë Shefki Oseku, që poashtu e boton një revistë letrare në Treleborg dhe që lutet për një *frymëzim* për vete si dhe për botën e tij "që të mbëltojë yje në kopshte poezie".

Kjo pëmbledhje me vjersha, e cila e himnizon Kosovën, është e ndarë në tre cikle: *Nënës, Dhembje e bukur dhe Një zog prore e vajton*, këtë "*ndërgjegje të mjegullt të Evropës*" dhe "*Miss Universum të Robërisë*". Megjithatë, poeti nuk e ka humbur shpresën për të ardhmen:..."*ne do të ngrihemi sërish / mbi plagët e brishta të plagëve tona / mbi muranat e lashta të eshtrave ilirikë*".

Në pjesën e dytë dhe të tretë, në poezitë e dashurisë kushtuar Doruntinës, me një gjuhë të pasur përshkruhen fuqitë e pashterrshme jetësore dhe hareja e rrojtjes. "*i dashuruari i përshpëritë në vesh lules, peshkut dhe blerimit*" / "*Lulëzon më bukur se vet trëndafili*" / "*gjithësia, ku ai i mbledhë yjet si margaritarë, është e vogël për fluturimin e tij të madh*"

Në mënyrë imponuese Shefkiu ikën nga dëshprimi: "*unë nuk banojë më në kufomën e qenies sime*".

---

PS. Ky punim u muarr nga Revista për Letërsi dhe Komunikim, "Zenit" nr. 1/2, muaji prill, viti 2002, botuar në Vien të Austrisë.

# ANA SPASOVSKA

## Dy dashuritë e mëdha të poetit

Duke marrë në dorë librin “Një lloj drite tjetër” të Shefki Osekut, akoma nuk parashikojmë se do të tërhiqemi në një vorbull çështjesh për ne të afërta. Oseku shkruan për atdheun e humbur, për padrejtësinë, e cila i ka ndodhur kombit të tij, për luftën dhe vendin e këtij kombi në hartën e Evropës. Është natyrshe që ne të mendojmë—poeti shkruan për Poloninë!

Oseku shkruan për dashurinë e madhe ndaj femrës. Shkruan për atë shkëlqim që na i merr netët e qeta dhe na i zgjatë ditët në pritje të pafundme për ta realizuar ëndrrën tonë. Për dashurinë, e cila na bën të jemi dashnorë të mrekullueshëm, por edhe na zhyt thellë në detin e pikëllimit. Oseku shkruan për dashurinë e pafat. Po, vallë, kjo ndjenjë-e huaj është për ne? Është krejtësisht e natyrshe të mendojmë—Oseku shkruan për ne!

Poeti shkruan për dashurinë dhe për të dashurën e tij, e cila është kaq larg, sa edhe afër. Dashurinë për të dashurën, e cila është e paarritshme, e njëkohësisht zgjon shpresa. Dashurinë, e cila duket e pamundur, por gjithsesi na mbush me kënaqësi, deri edhe me kënaqësinë ku përfshihet dhimbja. Është krejtësisht e natyrshe të mendojmë—Oseku shkruan për ne!

Por pasi kemi lexuar përmbledhjen “Një lloj drite tjetër” e kuptojmë se nuk bëhet fjalë për Poloninë dhe as për “të dashurën” tonë. Dy dashuritë e Osekut quhen: Kosova dhe Doruntina. Dhe, pikërisht këtyre dy dashurive të mëdha të jetës së vet Shefki Oseku ia kushtoi poezitë e tija të përfshira në këtë libër.

Poezitë patriotiko-politike të Osekut na njohin me atë anë të krijimtarisë së tij, e cila lidhet me historinë dhe të tashmen e Kosovës. Në vëllimin e vet të vogël poeti flet për çështje të rëndësishme dhe të dhimbshme për shqiptarët e Kosovës. Dhe këtu krijuesi, Shefki Oseku, nuk ka frikë të akuzojë, të kërcënojë

dhe të kërkojë qartësime prej gojës së atyre, që e kanë sjellë atdheun e tij në rënie dhe fatkeqësi. Pjesa më e vetëdijshme dhe e pamposhtur e tyre nuk reshti kurrë së shpresuari në pavarësinë e Kosovës. Tek ata hyn padyshim edhe poeti.

Dashuria e dytë e madhe e poetit është Doruntina. Oseku i kushton asaj atë pjesë të krijimtarisë së vet, që të kujton një këngë të madhe dashurie. Në të poeti nuk i kërcënohet askujt dhe askënd nuk e akuzon. E nëse ka vërejtje ndaj dikujt-atëherë kjo vërejtje drejtohen ndaj Zotit.

Poezitë erotike të Shefki Osekut lidhen drejtpërdrejtë me traditat më të mira të kulturës shqiptare. Ai krijon vjersha të mahnitshme, plot pamje të të dashurës, të natyrës, si dhe përshkrime delikate të gjendjeve shpirtërore dhe ndjenjave të poetit. Ndonëse nuk e arrin dot muzën, megjithatë ndjenjat e dashurisë Osekut vazhdojnë t'i japin shpresë për të ardhmen.

Oseku është optimist! Ai di të presë! Dhe le të mos e humbasin toruan përballë përshkrimeve të forta të dhimbjes në disa prej vjershave të tij. Kjo poezi lirike e pasqyron natyrën e vërtetë të Osekut-të pafat, të ndjeshëm, të dashur, plot gëzim dhe dëshirë për jetë-pra, natyrën e një patrioti dhe njëkohësisht të dashuruari.

PS. Parathënia e librit "Njëllor drite tjetër" botuar shqip – polonisht në nëntor të vitit 2004

## P Ë R M B A J T J A

### NËNËS

- 1.Nënës
- 2.Krushqit
- 3.Nusja
- 4.Dhëndëri
- 5.Shqipëria
- 6.Kosovës
- 7.S'paksa Zot, as Perëndi
- 8.Armiqtë
- 9.Vallja dyshe e shekullit XXI
- 10.Do të ngrihem i sërish
- 11.Emri im i pavdirë
- 12 - 16.Kopilat e Adamit
- 13.Dhunimi i Shën Paqes Virgjër
- 14.Kashë e lashë
- 15.Lajmet
- 16.Kosovari i mërguar
- 17.Ditë vere në Dukagjin I. II.
- 18.Lektisje e pashuar

## FOLE E DHEMBJES SË BUKUR

- 19.Frymëzimi
- 20.Poezi biblike
- 21.Kryevepra e Zotit
- 22.Hyn gjarpëri e del nuse shatselvi
- 23.Një lloj drite tjetër
- 24.Agon në ëndrra
- 25.Kaltëron det e qiell
- 26.Askund s'të lënë të qetë
- 27.Sytë e tu
- 28.Letra
- 29.Ditë vere
- 30.Natë vere
- 31.I dashuruari
- 32.Brenda një dite
- 33.Shpirt hyjnor
- 34.Edhe më e bukur në ëndrra
- 35.Fole e dhembjes së bukur
- 36.Pa titull
- 37.Njësoj e bukur
- 38.Një dritë që s'fiket kurrë

## NJË ZOG PRORE E VAJTON

- 39.Asgjë prej qiellit
- 40.Xhelozia
- 41.Këmbanë malli
- 42.Prore me ty
- 43.As në tokë, as në qiell
- 44.Fjala Jote
- 45 Gatniku
- 46.Dua të të harroj
- 47.Vjeshta
- 48.Zemra e poetit
- 49.Dashuri poeti
- 50.Malli
- 51.Në plazh
- 52.Ndarja I, II, III
- 53.E shkruar me gjak
- 54.Vetëm ti
- 55.Testamenti
- 56.Epitaf
- 57.Fati im
- 58.Kroi
- 59.Zotit
- 60.Ndërgjegjja
- 61.Kah vdekja
- 62.Baladë për poetin

PASTHËNIET 1, 2, 3.



# **S H E F K I O S E K U**

**Një lloj drite tjetër**

Përmbledhje me poezi

**Lektorë – korrektorë:**

**Shqiptar Oseku, Suedi**

**dhe**

**Hazyr Dervishi, Kosovë**

---

**Përpunimi kompjuterik:  
Frashër Oseku**

---

**U shtyp me ndihmën e ABF-it  
në Treleborg - Suedi**

---

**Për herë të parë u botuar më 1997**

**Ribotuar më 2004**

**Tirazhi 1.000 kopje**



## S H E F K I O S E K U

U lind më 15.03.1943 në Gjakovë, Kosovë. Në vitin 1963 UDB-a jugosllave e arreston dhe e dënon me një vit burgim të rëndë, për shkak të aktivitetit patriotik. E ka të kryer Fakultetin e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe si dhe atë Juridik. Në Kosovë ka punuar si arsimtar i gjuhës shqipe, por edhe si nëpunës.

Në Suedi ka emigruar që nga 16.04.1989. Punon si arsimtar i gjuhës shqipe në Treleborg. Kohë pas kohe ka shkruar poezi, të cilat i ka botuar në Kosovë dhe në diasporë.

Për herë të parë më 1997, në Treleborg të Suedisë, u botua përmbledhja me poezi "Një lloj drite tjetër". Për herë të dytë në prill të vitit 2000. Për herë të tretë në janar të vitit 2002. Ndërkaq për herë të katërt në mars të vitit 2002. Ky është ribotimi pestë, i përmirësuar. Kjo vepër është përkthyer në gjermanisht, suedisht, polonisht dhe anglisht.

Shefki Oseku merret edhe me prozë. Në prill të vitit 2000 autori e ka botuar romanin "Hetimet", ku pasqyrohet me besnikëri dhuna e UDB -së jugosllave ndaj rinisë liridashëse shqiptare.